Lëndë minerale, jo më shumë se	1

BIME MJEKESORE Rrënjë shpatore e qëruar	Rhizome iridis mudatum Iris florentina L. Iris pallid LAM dhe Iris germanica L.f Iridaceae
---	---

Kërkesat cilësore*Treguesit organo-shqisore*

Treguesit	Karakteristikat
Pamja	Rrënjë të grumbulluara në muajt korrik-tetor, të thata, të qëruara nga lëvorja dhe rrënjët e holla dhe nga pjesët e mbi tokës. Rizomat e trasha të çahan në 2 ose 4 pjesë, me dimensione, gjatësia 5-10 cm, në rizomat e qëruara dallohen rrënjët e holla, të pangrëna nga insektet.
Ngjyra	Të bardha, të bardha në krem e në të verdhë. Nuk lejohen rrënjë të nxira, të mykura, të kalbura, të prekura nga insektet dhe çdo lloji papastërie tjetër.

Treguesit fiziko-kimik

Treguesit	Norma %
Lagështira, jo më shumë se	12
Rrënjë me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	2
Rrënjë me dimensione nën 5 cm, jo më shumë se	5
Lëndë minerale, jo më shumë se	0.25

BIME MJEKËSORE Rrënjë shpatore e paqëruar	Rhizome iridis natural Iris florentina L Iris pallid LAM dhe Iris germanica L.f Iridaceae
---	--

Kërkesat cilësore

Treguesit organo-shqisore

Treguesit	Karakteristikat
Pamja	Rhizome të thata, të grumbuluara nga korriku deri në tetor, të paqëruara, të pastruara nga pjesët e mbi tokës dhe nga rrënjë të holla, rizomat e trasha të çara me dysh ose 4, me dimensione 5-10 cm gjatësi, pa aromë dhe të mos jenë të ngrëna nga insektet.
Ngjyra	Rrënjët nga jashtë të verdha deri në kafe, ndërsa nga brenda e bardhë krem në të verdhë. Nuk lejohen rizome të nxira, të mykura, të kalbura, dhe papastërti të ndryshme.

Treguesit fiziko-kimik

Treguesit	Norma %
Lagështira, jo më shumë se	12
Rrënjë me dimensione nën 2 cm, jo më shumë se	5
Rrënjë të prekura nga insektet jo më shumë se	3
Rrënjë me ngjyrë jonormale, jo më shumë se	5
Lëndë minerale, jo më shumë se	1

BIME MJEKËSORE Rrënjë valeriane	Rhizome valerianae Valeriana officinalis L.f. valerianaceae
---	--

Kërkesat cilësore

Treguesit organo-shqisore

Treguesit	Karakteristikat
Pamja	Rrënjë të zhvilluara, të thata, të pastra, të pastruara nga rrënjët e mbitokës, dherat dhe rrënjët e kalbura, rrënjët duhet të jenë të mbuluara me fibra dhe pjesërisht nga fibra të copëtuara. Me aromë të rëndë, aromë e keqe karakteristike e vetë bimës.
Ngjyra	Rrënjët nga jashtë kafe dhe benda të bardha. Nuk lejohen rrënjë të nxira, të mykura, të kalbura, dhe papastërti të ndryshme.

Treguesit fiziko-kimik

Treguesit	Norma %
Lagështira, jo më shumë se	12
Rrënjë me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	5
Lëndë organike të vetë bimës, jo më shumë se	1
Lëndë minerale, jo më shumë se	2

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Marrja e mostrës mesatare
---	------------------------------

Ky standard jep mënyrën e marrjes së mostrës mesatare në bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere.

Parimi i metodës.

Metoda bazohet në marrjen e një sasive materiali bimor nga pjesët e ndryshme të çdo paketimi, duke u përpunuar në mënyrën e përshkruar më poshtë, për të përfaqësuar plotësisht partinë e mallit.

Mënyra e marrjes së mostrës mesatare.

Në fillim përcaktohen paketimet që do të hapen në sasive që vijojnë: kur vijnë 1-4 paketime merren mostrat nga të gjitha paketimet, kur vijnë 6-10 paketime merren mostra nga 6 paketime dhe më tej për çdo 10 paketime merret mostër vetëm nga njëri paketim. Pra kur kontigjenti përbëhet nga një numër i madh paketimesh numri i paketimeve që do të hapen për tëu marrë mostra përcaktohet nga formula $n=5+ n-10/10$ ku n është numri i përgjithshëm i paketimeve.

Për të formuar mostrën, materiali merret nga pjesët e sipërme, të poshtëme dhe të mesit të çdo paketimi. Kur materiali është në trajtë pluhuri apo trajtë copash më të vogla se 1 cm, materiali që shërben si mostër merret me anë të një sonde farash. Për materialet e tjera bimore mostra merret me dorë. Për paketime që kanë përmasa të mëdha materiali të merret në thellësi prej 10 cm.

Të gjitha mostrat e marra bashkohen, përzihen me kujdes, për të mos rritur shkallën e coptimit të materialit bimor. Mostra fillestare e siguruar në këtë mënyrë rrafshohet mbi një sipërfaqe të sheshtë dhe ndahet në katër pjesët e barabarta. Dy pjesët e vendosura në anë të kundërta bashkohen dhe me dy pjesët e bashkuara vazhdon i njëjti proces, i cili përsëritet aq herë sa nxirret mostra mesatare prej 75-100 g, që është e mjaftueshme për të kryer të gjitha provat e nevojshme.

Me veprimin e fundit përgatiten dy mostra mesatare, njera prej të cilave dërgohet për analizë, ndërsa tjetra ruhet e mbyllur për rastet kur kërkohen analiza krahasuese.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i lëndëve të huaja
---	----------------------------------

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të lëndëve të huaja dhe të materialit bimor që është në kundërshtim me ngjyrën karakteristike të materialit të bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere.

Parimi i metodës.

Metoda bazohet në veçimin nga mostra mesatare të lëndëve të huaja në grupe sipas kërkesave me anë të vrojtimit me sy ose duke përdorur lente.

Aparatura Lente zmadhuese.

Mënyra e përcaktimit

Masa e mostrës që merret për përcaktimin e lëndëve të huaja varet nga lloji i materialit bimor: 500g për rrënjët, rizomat, lëvoret dhe barërat, 250 g për gjethet, lulet, farërat dhe frutat, 50 g për ato të copëtuara, 25g për ato të trajte pluhuri. Materiali bimor i peshuar, shpërndarë në një shtresë të hollë të njëtrajtëshme. Lënda e huaj përcaktohet me anë të vrojtimit me sy ose duke përdorur lente. Lëndët e huaja veçohen në grupe sipas kërkesave, peshohen me saktësi deri në 0.05 g.

Me të njejtën mënyrë përcaktohet dhe materiali bimor që është në kundërshtim me ngjyrën karakteristike të vetë bimës.

Me lëndë të huaja përveç përzjerjeve minerale (gurë, rërë, copëra dheu, pluhur që përcaktohen veç, sipas kërkesës, mund të konsiderohet edhe përzjerje bimësh të tjera, madje dhe përzjerje të pjesëve të po asaj bime, që nuk i përgjigjet emërtimit të bimës.

Mënyra e llogaritjes

Lëndët e huaja të veçuara në grupe sipas kërkesave peshohen me saktësi deri në 0.05g dhe përcaktohet përbërja në % (a) e çdo grupi lëndësh të huaja për materialin bimor të tharë në ajër sipa formulës: $a=100 \cdot p \div p$ ku pë - është masa e lëndës së huaj ose e materialit bimor që është në kundërshtim me ngjyrën karakteristike të bimës.

p - është masa e mostrës së marrë.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKËSORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i lëndëve minerale
---	----------------------------------

Ky standart jep mënyrën e përcaktimit të lëndëve minerale në bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në veçimin e lëndëve minerale nga mostra mesatare me anën e vrojtimit me sy dhe të sitjes.

Aparatura dhe reagentë

Sitë mëndafshi, sita me përmasa të ndryshme vrimash.

Mënyra e përcaktimit

Masa e mostrës që merret për përcaktimin e lëndëve të huaja varet nga lloji i materialit bimor: 500g për rrënjët, rizomat, lëvoret dhe barërat, 250 g për gjethet, lulet, farërat dhe frutat, 50 g për ato të copëtuara, 25g për ato në trajtë pluhuri.

Materiali bimor i peshuar shpërndahet në shtresë të hollë uniforme dhe me anën e syrit veçohen përzjerjet minerale (gurë, rërë, copra dheu) pastaj materjali bimor sitet. Për barëra, gjethë, rrënjë e rizoma përdorën sita teli me vrima me madhësi 2-3 mm, (për farëra, fruta e lule përdorën sita metalike me vrima me madhësi 0.5-1 mm).

Pjesa që kalon nëpërmjet sitës së parë, sitet edhe njëherë me sitë mëndafshi, pjesa që kalon sitën quhet pluhur dhe konsiderohet përzjerje minerale dhe peshohet së bashku me gurët, rërën dhe coprat e dheut të veçuar më parë.

Mënyra e llogaritjes

Lëndët minerale të veçura peshohen me saktësi deri 0.05g dhe përcaktohet përbërja në % e lëndëve minerale sipas formulës:

$$a=100 \cdot p \div m$$

ku pë - masa e lëndëve minerale

p - masa e mostrës së marrë.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i shkallës së thërmimit
---	---------------------------------------

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të shkallës së thërmimit të bimëve mjekësore, eterovajore dhe tanifere.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në sitjen e materialit bimor dhe në përcaktimin me anë të peshimit të sasisë së materialit që kalon sitën.

Aparatura dhe reagentë.

Sita metalike me vrima të rrullullakta me përmasa sipas kërkesës.

Sita me fije të pëlhurta me vrima katror dhe sitë me vrima me dimatër 0.25 mm.

Mënyra e përcaktimit

Thërmimi përcaktohet me anë të sitjes. Përmaset e vrimave përcaktohen për secilen lloj bime. Për sitjen e materialit me përmasa të vogla (fruta, fara etj) përdorën sita metalike me vrima të rrumbullakta, ndërsa për material që përbëhen nga objekte të trasha (rrënjë, bimë, gjethë etj, përdorën sita me fije të pëlhurta me vrima katrore.

Në qoftë se materiali është i thërmueshëm, sitja bëhet me kujdes me lëvizje rrotulluese, duke e tundur shumë lehtë sitën në mënyrë që të mos rritet thërmimi fillestar. Për materialet që nuk thërmohen gjatë sitjes, mund të bëhet përzierje. Në qoftë se materiali i thërmuar që fitohet, sitet për së dyti, përmas një site me dimatër 0.25 mm, pjesa që kalon sitën quhet pluhur dhe konsiderohet si përzierje minerale.

Mënyra e llogaritjes

Pas peshimit, përcaktohet përqindja e masës së thërmuar me anë të formulës:

$$a = 100 \cdot p \div p$$

ku p - masa e sasisë së thërmuar që kalon sitën.

p - masa e materialit të analizuar.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKËSORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i shkallës së dëmtimit të materialit bimor nga dëmtuesit e hambarit.
--	---

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të shkallës së dëmtimit nga dëmtuesit e hambarit.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në sitjen e materialit bimor dhe në numerimin në materialin që ka kaluar sitën të insekteve me anë të vrojtimit me sy, ose duke përdorur lente.

Parimi i metodës Metoda bazohet në sitjen e materialit bimor dhe në numerimin në materialin që ka kaluar sitën e insekteve me anë të vrojtimit me sy, ose duke përdorur lente.

Aparatura Lente dhe sita me përmasa 0.5 dhe 2.5 mm.

Mënyra e përcaktimit

Në qoftë se dëmtuesi është *Alleurobis farina* Degger, përcaktimi bëhet duke situr materialin për mes një sitë 0.5mm. Në materialin që e kalon sitën numërohen insektet me ndihmën e një lente të thjeshte. Materiali bimor konsiderohet i shkallës së parë të dëmtimit në qoftë se gjenden jo më shumë se 20 insekte për çdo kg material bimor, i shkallës së dytë kur gjenden më shumë se 20 insekte që levizin lirisht dhe nuk formojnë masë kompakte, e shkallës së tretë kur ka shumë insekte që formojnë masë kompakte ose kur lëvizja e tyre është e vështirësuar. Në qoftë se dëmtuesi është *Callandria granaria* përcaktimi bëhet duke situr materialin përmes një site 2.5 mm. Në këtë rast materialin bimor konsiderohet i shkallës së parë të dëmtimit në qoftë se gjenden 1 deri në 5 insekte, të shkallës së dytë kur gjenden 6-10 insekte dhe të shkallës së tretë kur gjenden më shumë se 10 insekte.

Në qoftë se dëmtuesi është *Tinea pellionella*. F. dhe sidotiepa panacea materialin bimor nuk sitet, por dëmtuesi veçohet me dorë. Shkalla e dëmtimit përcaktohet duke u nisur nga numri i dëmtuesve për çdo kg material bimor. Normat janë të njëjta me ato të përcaktuara për *callandria granaria*. L.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i hirit të përgjithshëm.
---	--

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të hirit të përgjithshëm në bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në djegjen e mostrës deri sa në të të mos mbeten shenja karboni. Për të penguar formimin e karbonit të forms së grafitit, që oksidohet me vështirësi dhe për të shmangur avullimin ose dekompozimin e klorureve dhe karbonateve, nxehja e mostrës të fillojë ngadalë, ndërsa djegja të përfundojë në temperaturë sa më të ulët (të mos kalojë 450⁰ C.)

Aparatura dhe reagentë

Mufel ose lllampe gazi, kroxhol porcelain, tretësirë e ngopur nitrati amoni.

Mënyra e përcaktimit

Për përcaktimin e hirit të përgjithshëm këshillohet të merren mostra nga 2-4 gr. Në qoftë se mostrat janë mjaft homogjene ose kanë përmbajtje të mëdha hiri (psh. 10% ose më tepër) mjaftojnë 2 gr, për mostra më pak homogjene ose përmbajtje të pakët hiri (psj. 5% ose më pak) janë të nevojshme 4g për mostrat mesatare.

Materiali i grirë në masën e lartpërmendur vendoset në një kroxhol porcelain të përshtatshëm, që është kalcinuar dhe peshuar paraprakisht. Materiali bimor përhapet në kroxhol në shtresë të rrafshët dhe peshohet me kujdes. Pastaj përmbajtja e kroxholit digjet duke e rritur gradualisht nxehësinë, por duke mos i kaluar 450⁰C, derisa të mos përmbajë më karbon, ftohet në një eksikator dhe peshohet. Në qoftë se nuk digjet i tërë karboni i mostrës, krexholi ftohet dhe mbetja njomet me rreth 2ml ujë ose më mirë me tretësirë të ngopur nitrati amoni. Thahet më parë në banjo uji, me pas në furnellë dhe se fundi kalçinohet deri në masë të pandryshueshme.

Mënyra e llogaritjes

Përmbajtja në % e hirit të përgjithshëm, llogaritet sipas formulës:

$$a=100 \cdot p \div p$$

ku pë - masa në gram e hirit që gjendet në kroxhol.

p - masa në gram e mostrës që analizohet.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i hirit sulfat.
---	-------------------------------

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të hirit të sulfatit në bimët mjeksore, eterovajore e tanifere.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në trajtimin e materialit bimor në acid sulfurik dhe djegjen e tij në temperaturë 800°C.

Aparatura dhe reagentë

Mufel ose llampe gazi, kroxhol porcelain, acid sulfurik i përqendruar, karbon amoni.

Mënyra e përcaktimit

Në një kroxhol porcelain të kalcinuar e të peshuar paraprakisht vendosen 1-3 g material i grirë. Sasia e materialit që nxirret përcaktohet si në rastin e përcaktimit të hitit të përgjithshëm. Shtohen në kroxhol rreth 2ml acid sulfurik (me dendësi afërsisht 1760g/l). kroxholi nxehet fillimisht mbi furnelë derisa mostra të karbonizohet dhe pastaj kalçinohet me kujdes derisa mostra të karbonizohet dhe pastaj kalçinohet me kujdes deri në 800°C, derisa të mos ketë më karbon.

Më pas kroxholi ftohet dhe i shtohen disa pika acid sulfurik për të njomur hirin e përftuar. Kroxholi pas shtimit të acidit nxehet në fillim me anë të një furnele dhe më pas kalçinohet njësoj si herën e parë. Së fundi, pas ftohjes, në kroxhol shtohet pak karbonat amoni (kristale) dhe kalçinohet deri në masë të pandryshueshme.

Mënyra e llogaritjes

Përbajtja në % e hirit sulfat, llogaritet sipas formulës:

$$a=100 \cdot p \div p$$

ku pë - masa në gram e hirit që gjendet në kroxhol.

p - masa në gram e mostrës që analizohet.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i hirit të patretshëm në acid.
---	--

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të hirit të patretshëm në acid në bimët mjekësore, eterovajore e tanifere.

Parimi i metodës

Metoda bazohet në trajtimin e hirit të përgjithshëm ose të hirit sulfat me acid klorhidrik të holluar, filtrimin e mbetjes, shplarje e filtrit me ujë të nxehtë dhe djegjen e materialit që mbetet mbi filtër së bashku me vetë filtrin.

Aparatura dhe reagentë

Mufel ose llampë gazi, acid klorhidrik (afërsisht 2N) kroxhol porcelani, letër filtri që sëka mbetje hiri, xham sahati.

Mënyra e përcaktimit

Në kroxholin që përmban hirin e përgjithshëm ose hirin sulfat shtohen 25 ml acid klorhidrik (që përmban afërsisht 70g/l pra afërsisht 2 N), mbulohet me xham sahati dhe vlohet lehtë për 5 minuta. Shplahet xhami i sahatit me 5 ml ujë të nxehtë duke i kaluar ujrë e shplarjes në kroxhol. Përmbajtja e kroxholit mblidhet mbi një letër filtri që nuk le hi dhe shplahet me ujë të nxehtë derisa filtrati të mos tregojë reaksion acid. Pas shplarjes letra e filtrit që përmban lëndët e patretura në acid, kalohet në kroxholin që kemi përdorur, thahet mbi një furnelë dhe kalçinohet deri në masë të pandryshueshme.

Mënyra e llogaritjes

Përmbajtja në % e hirit të patretshëm në acid, llogaritet sipas formulës:

$$a=100 \cdot p\bar{e}/p$$

ku p \bar{e} - masa në gram e hirit që gjendet në kroxhol.

p - masa në gram e mostrës që analizohet.

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKËSORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i mbetjes së thatë.
---	-----------------------------------

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të mbetjes së thatë në bimët mjekësore, eterovajore e tanifere (që njëkohësisht jep mënyrën indirekte të përcaktimit të lagështirës).

Parimi i metodës Metoda bazohet në tharjen e materialit bimor në temperaturë 100-105°C, në thermostat ose në tharjen në temperaturën e dhomës në eksikator, me anhidrid fosforik anhidër. Tharja vazhdohet derisa masa e materialit në dy peshime të njëpasnjëshme me një interval kohe prej 30 min të mos ndryshojë më shumë se 5 mg.

Aparatura dhe reagent Thermostat, eksikator, anhidrid fosforik anhidër.

Mënyra e përcaktimit Në një pezafilter vendosim 2-10g material bimor, sipas rastit, që është peshuar me kujdes në një pezafilter të thatë. Materiali bimor tëi ketë coprat jo me të medha se 3 mm, të prera ose të copëtua. Farërat ose frutat të copëtohen, ndërsa ato që janë më të vogla se sa 3 mm të krisen (çahen). Tharja e mostrës të bëhet në pezafilter dhe jo në pjata petri apo xham sahati, sepse pas tharjes kapaku i pezafiltrit pengon rithithjen e lagështirës së mjedisit rrethues nga ana e materialit bimor. Mostra thahet sipas njerës nga tre mënyrat e treguara më poshtë. Derisa dy peshime të njëpasnjëshme çdo 30 minuta të mos japin ndryshime në masë më shumë se 5 mg. Peshimi i parë bëhet jo përpara se të jenë mbushur 4 orë tharje. Mostra thahet në njerën nga këto tre mënyra:

- Tharje në thermostat në 100-105°C për rreth 5 orë para peshimit të parë.
- Tharje në eksikator mbi anhidrid fosforik në presion atmosferik dhe temperaturën e dhomës.
- Tharje në eksikator mbi anhidrid fosforik në vakum dhe temperaturën e dhomës.

Mënyra e llogaritjes Llogaritja e mbetjes së thatë bëhet sipas formulës:

$$a=100 \cdot p \div p$$

ku p - masa e mostrës pas tharjes.

p - masa e mostrës pas tharjes (e materialit të thatë në ajër).

Në qoftë se kërkohet përqindja e lagështirës (së bashku me lëndë volatile) që përmban materiali, llogaritja bëhet sipas formulës: $a=100 \cdot (p-p) \div p$ ku: p dhe p shprehin të njëjtat specifitime si më lart.)

METODAT E ANALIZAVE KIMIKE

BIME MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE	Përcaktimi i lagështirës.
---	------------------------------

Ky standard jep mënyrën e përcaktimit të lagështirës në bimët mjekësore, eterovajore e tanifere.

Parimi i metodës

Përcaktimi i lagështirës në bimët mjekësore, eterovajore dhe tanifere bëhet me anë të metodës azeotropike, e cila bazohet në vlimin e materialit bimor me një tretës që nuk përzihet me ujin zakonisht toluenë. Gjatë vlimit uji i pranishëm në material merret nga tretësi, distilohet së bashku dhe pas kondensimit uji veçohet duke rënë në fund.

Aparatura dhe reagentë

Për përcaktimin e lagështirës nevojitet një aparat qelqi Din- strak dhe 200ml toluenë (ose ksilen) si tretës për çdo përcaktim. Toulenti përdoret përsëri në përcaktimet e tjera.

Mënyra e përcaktimit

Në ballonin e tharë të aparatit futen 200 ml, toluen dhe rreth 2 ml ujë. Përmbajtja e ballonit distilohet për rreth 2 orë, lihet të ftohet për 30 minuta dhe lexohet në tubin e graduar vëllimi i ujit të mbledhur (me saktësi prej 0.05 ml). Pas kësaj në ballon vendoset një sasi e tillë mostre që të përmbajë rreth 2-3 ml ujë (mostra peshohet me saktësi deri në të qintat e gramit). Nxehja e ballonit të aparatit bëhet në mënyrë të tillë që nga refregjeranti të bien rreth 2 pika në sekondë, derisa të largohet shumica e ujit që parashikohet, ndërsa më vonë rritet ritmi i distilimit deri rreth 4 pika në sekondë.

Pasi të përfundojë distilimi i tërë ujit, shplahen faqet e brendëshme të refrigjerantit me toluen dhe distilohet edhe për 5 minuta. Pastaj burimi i nxehtësise, pritet që aparati të ftohet deri në temperaturën e dhomës dhe lexohet vëllimi i ujit të grumbulluar.

Mënyra e llogaritjes

Llogaritja e lagështirës bëhet sipas formulës: $a=100*(n\ddot{-}n)/p$
ku n - numri i mililitrave të ujit të përdorur në distilimin e parë (pa praninë e materialit)

p - masa e materialit që analizohet në gram

në - numri i përgjithshëm i mililitrave të ujit përfundimtar të

grumbulluar në tubin e graduar.

Ruajtja dhe transportimi

Artikujt bimorë të ruhen në magazinë të pastra, të ajrosura pa lagështirë, me hapësirën dhe ndriçimin e nevojshëm, të moslejohen rënia direkt e rrezeve të diellit mbi to. Artikujt bimor vendosen mbi dysHEME të shtruar me dërrasë. Kur dysHEMEJA është prej çimentoje vendosen kavaleta dërrase me këmbëza 10-15 cm të larta dhe mbi to vendosen bimët ose ballot, thasët ose kutitë e kartonit me bimë. Ballot, thasët e kutitë e kartonit me bimë vendosen 50 cm larg mureve të magazinës.

Ballot, thasët sivosen nga 4-7 copë njëri mbi tjetrin, kurse kutitë e kartonit vendosen sipas llojit të bimës, vëllimit dhe masës së tyre. Në magazinë të këtë rrugë kalimi për të kontrolluar gjendjen e bimëve dhe për të bërë manipulimet e nevojshme. Në çdo 3-4 rradhë me thasë, ballo ose kuti kartoni të lihet rrugëkalimi.

Transportimi i artikujve bimor bëhet me çdo lloj mjete të pastër dhe të mbulura kur koha është me shi. Bimët helmuese të forta ruhen, manipulohen dhe ambalazhohen në dhoma veç nga bimët e tjera jo helmuese.

Për të gjithë ata që eksportojnë në ShBA ERËZA TË PASTRA -PËRCAKTIMET E ASTA-s MBI PASTËRTINË QË KANË HYRË NË FUQI MË 28 PRILL 1999

Specifikimet e ASTA-s për pastërtinë

Sipas standardeve, lëndë e huaj përkufizohet çdo material i huaj që gjendet në produkt dhe kjo përfshin, por nuk kufizohet vetëm në: pluhur, fije, kërcenj, shkopinj, fara të huaja jo helmuese, jashtëqitje, lëndë organike dhe ndotës me origjinë shtazore. Niveli i lejuar i përmajtjes së ndotësve, sipas standardeve duhet të jetë nën ato vlera që janë paraqitur në tabelën e mëposhtëme me përjashtim të kolonës Δ "Insekt i plotë, i ngordhur", sasia e të cilave nuk

duhet të rejkalojë në mënyrë kategorike, kufijtë e paraqitura në tabelë.

Emri i Erëzave, apo herbave farave	Δ Insekt i plotë i ngordhur	Jashtëqitje gjitarësh	Jashtëqitje të tjera	Myqe	Dëmtime/ Infektive nga insektet	Lëndë të huaja
	Në numër	Në mg/0.5 kg	Në Mg/0.5kg	% sipas peshës	% sipas peshës	% sipas peshës
Anisi	4	3	5	1	1	1
Borzilok i ëmbël	2	1	2	1	1	0.5§
Kardamon/cynara	4	3	1	1	1	0.5
Sena	2	1	1	5	2.5	0.5
Spec Djegës Kilian	4	1	8	3	2.5	0.5
Karafli*	4	5	8	1	1	1
Koriandër	4	3	10	1	1	0.5
Farë Kumeli/ bar gjumi	4	3	5	1	1	0.5
Fara kopre	4	3	2	1	1	0.5
Fara Maraje/ finoku	SF(2)	SF(2)	SF(2)	1	1	0.5

Gjethe dafine**	2	1	10	2	2.5	0.5
Manxurana	3	1	10	1	1	1\$
Rigon***	3	1	10	1	1	1\$
Fara lulëkuqe	2	3	3	1	1	0.5
Gjethe rozmarine	2	1	4	1	1	0.5\$
Sherebelë**	2	1	4	1	1	0.5
Trumza	2	1	10	1	1	0.5\$
Tarragon/Pelin	2	1	1	1	1	0.5\$

Standardet e pastërtisë-shpjegime

** Gjethe dafine & Sherebelë

“kërcejtë”, për arsye ekonomik, konsiderohen ndryshe; nuk ndiqet kriteri: ka apo nuk ka kërcenj (po pati kërcenj) duhet pastruar, po nuk pati kërcenj nuk duhet pastruar).

*** Rigoni Analizat për përmbajtje Cëmërdelli (Cotinus coggyria scop) nuk janë të detyrueshme nëse në mostra shënohet “Produkt Meksikan”.

* Insekte të ngordhura_Nuk duhen kaluar kategorikisht kufijtë e treguara në tabelën e mësipërme.

* Material i huaj Përfshin pjesë të tjera bimësh si p.sh gjethe të bimëve të tjera.

Udhëzime për nivelet maksimale të lagështisë në erëza Qershor 1991

Borzilok	12%
Gjethe dafine	9%
Kardamoni	12%
Fara Koriandri	9%
Farë bar gjumi (Kumeli)	9%
Fara finoku	10%
Rigon	10%
Fara lulëkuqeje	9%
Rozmarinë	10%
Sherebelë	10%
Tarragon (pelin)	10%
Timus	10%

AMBALLAZHIMI

I BIMËVE MJEKESORE, ETEROVAJORE DHE TANIFERE
Në ballo me masë neto 50 kg me përmasa 55x60x70 ±2 cm prej
pambuku, beze, ose polyester për bimët e paprocesuara dhe dhe
voluminoze

Lule akacie	Fletë qershigle
Lule blini argentea	Fletë rrush ariu
Lule kokeli me bisht	Fletë sherebele
Lule çikore	Fletë tatulli
Lule gjineshtre (lule xane)	Fletë ulliri
Lule murrizi me fletë	Fletë fiery mashkull
Lule mëllage	Bar arsi
Lule shtogu veshtull	Bar blete
Lule tërfil i bardhë	Bar çaj mali
Fletë angjinare	Lule aguliçe
Fletë blini	Lule blini
Fletë dëllinjë e zezë	Lule kokëli pa bisht (petalet)
Fletë manaferre	Lule zogu
Fletë ferre zvarranike	Lule manushaqe
Fletë gështenje	Lule mijëfletëshe
Fletë dielli e ngushtë	Lule tërfil i kuq
Fletë hithri	Fletë arrë
Fletë landro	Fletë barblete
Fletë luleshtudhe	Fletë ekualipti
Fletë manushaqe	Fletë mjedre
Fletë mersine	Fletë frashëri i bardhë
Fletë mëllage e bardhë	Fletë dielli e gjerë
Fletë murrizi	Fletë helmarine
Fletë netulle	Fletë lajthie

Flet lotzoje	Bar tamlagjaku
Fletë luletogezi leshtor	Bar fik uku
Fletë mareje	Bar hithri
Fletë mështekne	Bar kamomili
Fletë mëllage	Bar kin fushe
Fletë mushkrije	Bar lulebasani
Fletë hardhie	Bar mendër gjethegjatë
Fletë qumështore	Bar njëgjire
Fletë shelgu e bardhë	Bar pelini i zi
Fletë shtogu	Bar qumështore
Fletë thundër mushke	Bar rigon i bardhë
Fletë vjeshtull	Bar trumze
Bar pate	Bar vjeshtulle
Bar bisht kali	Bar qerbashi
Bar shtrapere	Maja të lulëzuara të bargjakut
Bar çikore	Bar majdanoz i egër
Bar hermarine	Bar majasëlli
Bar jonxhe e egër	Lëvore fasule të bardha
Bar kalaminti	Rrënjë e kuqe
Bar krizantene	Rrënjë grami pa fijeza
Bar mendër e egër	Rrënjë hithri
Bar mijëfletësh	Rrënjë qumështore
Bar pelini i bardhë	Rrënjë shperndre
Bar pondiqe e egër	Rrënjë rrushkulli
Bar rigon i kuq	Rrënjë skopolie
Bar sporisi mjeksor	Bishta qershie dhe vishnje
Bar veronike	Myshk pishë
Bar zhumbrice	Myshk shkoze

Qepë deti e thatë	Buqetë sherebeli
Fletë dafine	
Bar trumze e kopshtit	Në thasë pambuku ose
Petale luledielli	polyestër me masë neto 25 kg
Bar psoralea	si dhe në thasë prej letre 10-
Bar papinollës, kundër	20 kg sipas peshës specifike të
verdhëzes	bimës.
Buqeta sherebele	Lule kulumbrie
Rrenej aguliçe	Lule portokalli
Rrënjë çikore	Trumzë e shkoqur
Rrënjë grami me fijeza	Rigon i kuq i shkoqur
Rrënjë mëllage e bardhë e	Zhumbricë e shkoqur
qëruar	Frut konopice
Rrënjë qumështore me fletë	Kokër limoni aguridh
Rrenej rodhe e madhe	Kokër mersine
Rrënjë valeriane	Kokër murrizi
Myshk dushku	Kokër qershgle e egër
Myshk ahu	Kokër vordhëze e egër
Mustaqe misri	Kallinj të frutifikuar të gjethe
Lule piretrumi	diellit të gjerë
Bar shëngjini	Kokërr gështenje e egër
Petale të lulëkuqes	Farë sinap i bardhë
	Farë sinap i kuq
Në ballo ose thasë, beze ose	Lëvore kokërr arrë
polyestër: 50 kg për ballo dhe	Lëvore shegë e egër
25 kg për thasë	Lule lavandul e thatë
Shqeme dhe Cermedell	Lëndë lisi
Tufa mersine	Bar timus i shkoqur

Bar hyssopis i shkoqur	Lëvore dushku
Lëvore kokërr gështenje e egër	Lëvore shtogu
Lëvore portokalli	Rrënjë fik ujku
Lëvore vishi	Rrënjë gjuhë nuse
Lëvore farës gjështenjës së egër	Rrënjë stërkungulli
Rrënjë genti	Rrënjë shkumbake
Rrënjë helmarine	Rrënjë shpatore e pa qëruar
Lue murrizi pa fletë	Bri thekri
Lule shtogu	Sythe plepi i zi
Bar mendër e egër e shkoqur	Tubere (zhardhok) salepi
Rigon i bardhë i shkoqur	Bar borzilok i thatë
Frut kërkute	Manxurane e shkoqur
Kokër kulumbrie	Shëngjin i shkoqur
Kokër portokalli aguridh	Trumzë kopshti e shkoqur
Mollë të egra të grira të thara	Frut koriandri
Kokër nerënxe agurish	Lule netull
Kokërr shtogu	Gëzhjojë valanidhi
Frut drize	Rrënjë shpatore e qëruar
Farë kungulli	Rrënjë shtarrë
Farë sinap i zi	Sythe pishë
Farë xhirokulli (në thasë stof dopio)	Guacka bajamesh
Farë kumeli	Fletë rozmarine
Gogla dushku	Borzilok i shkoqur
Lule shëngjin i thatë i shkoqur	Bar mendër i butë
Lëvore arrçi (drunakuq)	Bar manxurane
Lëvore nerënxe	Frut glikanxo
	Frut anasoni

Në thasë prej pëlhure, zhuke ose gjineshtre me masë neto 25 kg.

Kokër dëllinjë e kuqe
 Kokër trendafil i egër pa Farë
 Kokër dëllinjë deti
 Kokër dëllinjë e zezë
 Kokër dëllinjë e zezë 7 mm
 Rrënjë fieri mashkull

Gjithë një transporti në dhoma frigoriferike dhe në arka ambalazhi plastike ose druri si dhe fuçi druri me tretësirë SO₂

Kokër trëndafil i egër i njomë
 Kokër luleshrudhe e njomë
 Kokër manafere e njomë
 Frut qershigle i njomë

Në kuti kartoni ose në thasë prej letre

Fletë portokalli e njomë
 Fletë zhuke të thata (të lidhura në tufa)
 Lastar xane
 Bar borzilok i njomë
 Bar manxurane i njomë

Bar mendër e butë i njomë
 Bar shëngjin i njomë
 Bar trumzë kopshti e njomë
 Bar lavandul e njomë
 Lule shëngjin i njomë
 Bar timus i njomë
 Bar hisopus i njomë

Në kuti kartoni të valëzuara 5 fijesh me masë neto 10 kg me dimensione 56x46.5x25.5 cm

Lule gështënje e egër
 Lule kamomili
 Pluhur lule kamomili
 Lule shqerrë
 Lule thundër mushke

Të gjitha këto përkujdesje dhe normative nuk do të kishin kuptim në se nuk do të mbahen parasysh ashtu siç paralajmërojnë dhe shoqatat tona si motra, ajo Amerikane apo Evropiane për të patur parasysh dhe në qendër të vëmendjes.

PESTICIDET

Pesticidet që lejohen të përdoren në SHB në Erëza, Fara, Herba

Bashkëlidhur është një listë me pesticide të cilat lejohen nga Agjensia Amerikane e Mbrojtjes së Mjedisit për t'u përdorur. Kjo listë rishikohet periodikisht për të reflektuar ndryshimet e bëra nga AMM (EPA). Këto janë paraqitur në pjesën 40 e Kodit të Standardeve Federale botuar më 1 Korrik 1999. Seksioni 180 bën fjalë për toleranca në përdorimin e pesticideve, sipas bimëve, në lëndë të para bujqësore, ndërsa seksioni 185 bën fjalë për toleranca në përdorimin e shtesave në ushqime të përpunuara njerëzish apo kafshësh.

Standardet mbi përmbajtjen e mbetjeve të pesticideve në ushqime njerëzish dhe kafshësh përcaktohen në Seksionin 402 të këtij ligji i referohen ushqimit të njerëzve /kafshëve që prodhohen në vend apo importohen por që provohen se përmbajnë mbetje pesticidesh. Për këtë arsye, jashtë Amerikës, nuk i nënshtrohen kërkesave të Agjensisë Amerikane të Mbrojtjes së Mjedisit – AMM (EPA), kërkesa që përcaktohen në Aktin Federal mbi përdorimin e Insekicideve, përsëri sasia e mbetjes së pesticideve në ushqime njerëzish apo kafshësh, që hyjnë në Amerikë, duhet të jetë në nivelin e tolerancave apo kufijve të përcaktuara nga AMM (EPA). Në rastin kur mbetjet e pesticideve janë të paevitueshme, atëherë AUI (FDA) përcakton një nivel kritik. Më poshtë përshkruhen standardet e përdorimit të gjithë tipeve të pesticideve. Përkufizimet e sakta jepen në Kodin e Standardeve Federale.

Toleranca në përdorimin e pesticideve

Tolerancat mbi sasinë maksimale të pesticideve në ose mbi lëndë të para bujqësore janë përcaktuar nga AMN (EPA) në Seksionin 408 të Ligjit Federal mbi Artikujt Kozmetikë dhe Farmaceutikë. Sipas po të njëjtit Seksion, AMM autorizohet gjithashtu, që të mos lejohet toleranca për mbetje pesticidesh në lëndë të para bujqësore. Tolerancat apo mostolerancat marrin rëndësi të jashtëzakonshme atëherë kur AMM jep leje për regjistrimin e një pesticidi të caktuar, sipas rregullave të Ligjit Federal mbi Artikujt Kozmetikë dhe Farmaceutikë, pesticid i cili do të përdoret në SHBA në ushqime njerëzish apo kafshësh.

Toleranca për pesticidet në aditivët ushqimorë

Tolerancat dhe mostolerancat mbi përdorimin e aditivëve ushqimorë përcaktohen në Seksionin 409 të LFAKE. Ky ligj bën fjalë për nivelet e mbetjeve të pesticideve që akumulohen në lëndët e para bujqësore që më

pas përdoren për prodhim, por në asnjë mëyrë këto mbetje nuk duhet të kalojnë nivelet e lejuara. ASTA inkurajon tërë ata që furnizojnë industrinë e erëzave për tu përfshir në luftën e integruar kundër sëmundjeve dhe dëmtuesve. Megjithatë, edhe nëse lind nevoja e përdorimit të pesticideve, këto të fundit duhen përdorur aty ku dhe siç duhet pa dëmtuar shëndetin e njeriut apo cilësinë e produktit. Pesticidet duhen përdorur në përputhje me standardet e vendit ku përdoren dhe standardet e vendit ku do të tregëtohen këto produkte.

Në të njëjtën kohë, ne dimë që përdorimi i pesticideve është nën shqyrtim të hollësishëm nga shkencëtarët dhe specialistët përkatës. Prandaj ne inkurajojmë furnizuesit që përdorin pesticide që të marrin parasysh opinionin e specialistëve dhe shkencëtarëve, opinionin i cili ndryshon vazhdimisht. Duam tëju kujtojmë gjithashtu që standardet dhe rregullat e paraqitura në këtë material edhe mund të ndryshojnë.

SPECIFIKIMET E ASTA-s PËR PESTICIDET

Cituar në Pjesa 40 e KSE, seksioni 180	Pesticidi	A lejohet të përdoret	Toleranca në ppm	Shpjegime
§180.108	Asefat	Po	4	Piperët (të cilët nuk duhet të kenë më shumë se 1 ppm O, S- di metil fosforamidotiat)
§180.1002	Alletrin	Po	Sëka	Piperet (bardhë, i zi)
§180.225	Fosfid alumini	Po Po	0.01 0.1	(A) fumigant paravyeljes kundër vatrave të dëmtuesve në farat e suzamat.
§180.1121	Acid Borik e kripëra të tij	Po	Sëka	(A)
§180.103	Kaptan	Po	25	Piper (i bardhë, i zi)
§180.169	Karbaril	Po	10	Piperet (i bardhë, i zi), kopra e freskët.
§180.254	Karbofuran	Po	0.02	Piperet (të cilët nuk duhet të kenë më shumë se 0.2 ppm karbamat)
§180.342	Klorpirifos	Po	1	Piperet (i bardhë, i zi)
§180.1001.1	Preparate me baë Bakri	Po	Ska	(A)
§180.414	Kiromazinë	Po	1	Piperet (i bardhë, i zi)
§180.235	2.2-DDVP	Po Po	0.5 2	(A) panvarësisht nga përmbajtja e yndyrave (A) mbi 6% yndyra

§180.204	Dimetoat	Po	2	Piperet (i bardhë, i zi)
§180.221	Difonat	Po	0.1	Mentha piperita, mentha spicata
§180.182	Endosulfan	Po	2	Piperet F.
		Po	0.2	Mustard
§180.151	Oksid etileni	Po	50	Në të gjitha erëzat
§180.130	C i a n i d e Hidrogjeni	Po	250	(C)
		Po	25	Suzam
§180.375	Fosid Magnezi	Po	0.01	Piperet (i bardhë, i zi) pas vjeljes.
		Po	0.01	(A) para vjeljes
§180.111	Malation	Po	8	Piperet (i bardhë, i zi)
§180.120	Metoksiklor	Po	14	Piperet (i bardhë, i zi)
§180.123	Metil bromid	Po	100	Në bar gjumi pas vjeljes. Në rrenjë e
		Po	100	xhëndërfillës para dhe pas vjeljes. piperet
		Po	30	(i bardhë, i zi) pas vjeljes.
§180.215	Naled	Po	0.5	Piperet (i bardhë, i zi) (A), përdoret dhe
		Po	0.5	kundër insekteve (miza, mushkonja)
§180.328	Naproamid	Po	0.1	Borzilok, manxura, menta, piperet, rozmarina dhe trumëza (verore dhe dimrore)
§180.456	Oksadiksil	Po	0.1	Piperet, xinxërfilla dhe Kurkuma
§180.121	Paration	Po	1	Piperet (i bardhë, i zi)

§180.222	Prometrin	Po	0.3	Kopra- tolerancë rajonale
		Po	0.1	Majdanoz- tolerancë rajonale
§180.2	Sqfur	Po	Sigurtë	(A), ndiqni udhëzimet e etiketës 7
§185.200	Fosfid Alumini	Po	0.01	(A) kur përdoret si fumigant
§185.650	D i o k s i d karboni	Po	Sëka	(A)
§185.1900	2.2 – DDVP	Po	0.5	(A) kur përdoret në paketën apo kuti me ushqime të paskadueshme
§185.2850	Oksid etileni	Po	50	(B)
§185.3800	Fosfid magnezi	Po	0.01	(A) fumigant për pas vjeljes
§185.3700	Metil bromid	Po	400	(A)
§185.4400	Klorpirifos	Po	1	Piperet (i bardhë, i zi)
§185.5150	Preparate me bazë bakri	Po	Sëka	(A)
§185.5200	2.2 ddvp	Po	0.5	(A)pamvarësisht nga përmbajtja e yndyrave
		Po	2	(A) mbi 60% yndyrë.
§185.4400	Azot	Po	Sëka	(A)
§185.4900	B u t o k s i d pipetonili	Po	10	(D) ruajtje pas vjeljes- lexo standardet
§185.5150	Oksid propileni	Po	300	(B) erezat të përpunuara
§185.5200	Piretrinë	Po	1	(D) ruajtje pas vjeljes- lexo standardet

Shënime:

A. Përfaqëson - Lëndë të Para Bujqësore.

B. Përfaqëson - Bimët Aromatike Mjekësore që ndahen në dy grupe si më poshtë:
Grupi i bimëve 19A - angelica; balsam; borziloku; shaja; lulekomishti; kamomili; nepeta cataria; antrisku (tharë); allium schonoprasum; allium schonoprasum kineze; clary; koriandri; (gjethet); crysanthemum balsamita; culantro (gjethet); murraya paniculata (gjethet); gjethe kpër; marubi; hisopi; lavandula; cymbopogosp; levisticum officinale (gjehe); kumak, manxura, pusqark; majdanozi; majdanozi; pennyroyal; rozmarina; syzë; shereblea; trumza; dafinë e ëmbël; karajpeli; pelin; timusi; gamtheria procumbens; galium adoratatum dhe artemisa absinthium.

Grupi i bimeve 19B – pimenta; anisi; anise star; bixa orellana; caparis spinosa; karaboti; karaboti i zi; kardamoni; sena; culantro; bar gjumi; dill; kopra e zakonshme; finoku; trigonella foenum- graecum; agrana paradisi; dëllinjë; levisticum officinale; myristica fragrans; mustard; myristica fragrans; piper i bardhë dhe i zi; lulëkuqja; shafrani dhe vanilja.

C. Përfaqëson – erëzat dhe Barnat të përkufizuara si pimenta, anisa, borziloku, dafina, piperi i zi, karaboti, sena, farat e selinosë, specat djegës kilian; kanella, karafili, koriandri, bar gjumi, kopra, xhënxërfilla; myristica fragrans, manxuraja, myristica fragrans (fara), rigoni, specat, lulëkuqja, piper i kuq; rozmarina; sherebela; trumza, trumza, timusi, kukuma dhe piperi i bardhë.

D. Përfaqëson – ushqime të thata.

Lëndët e huaja

Në përpjekje për të patur uniformitet midis standardeve të laboratorëve të aprovuar (miratuar) nga ASTA dhe të gjithë kësaj industrie, komiteti i Standardeve ka formuluar përkufizimet e mëposhtëme mbi lëndët e huaja, përkufizime të cilat paraqiten në Metodat Zyrtare analitike të Shoqatës Amerikane të Tregëtimit të Erëzave (ASTA), botimi 4.

Përkufizime të materialeve bimore të huaja/kërcejve

Sherebela: – nëse materiali bimor palcor, në çdo pikë të trupit të tij ku ka bashkime, ka diametër më të madh se 1 mm, i hiqen gjethet dhe nëse gjatësia e kalon 12.5 mm, atëherë ky material do të quhet kërcell. Për më tepër, nëse materiali bimor palcor, ka diametër më të madh se 2 mm, në çdo pikë të tij atëherë kjo pjesë quhet kërcell pamvarësisht nga gjatësia e tij. Këto pjesë të quajtura kërcell peshohen dhe pesha totale e tyre përllogaritet më pas në %.

Gjethë dafine: - nëse materiali bimor palcor, përjashtoj sythat, ka diametër më të madh se 1 mm në çdo pikë të trupit ku ka bashkime, atëherë i hiqen gjethet dhe nëse gjatësia e tij tashmë i kalon 12.5 mm, atëherë ky material do të quhet kërcell panvarësisht nga gjatësia e tij. Ky material peshohet dhe pesha totale e kërcejve shprehet në %.

Rozmarina dhe trumëza: - analizuesi përcakton një madhësi mesatare gjethesh për një kontigjent të caktuar. Çdo material bimor palcor, përjashtoj këtu gjethet, i cili e kalon madhësinë/dimensionet e përcaktuara, konsiderohet si material i huaj.

Timus: - nëse materiali bimor palcor e kalon gjatësinë 12.5 mm, atëherë ai konsiderohet si lëndë e huaj.

Rigoni: - Nëse materiali bimor palcor ka dimensione më të mëdha

se 1 mm në çdo pikë të tij ku ka bashkime, atëherë gjethet e bashkangjitura hiqen dhe nëse madhësia i kalon 12.5 mm, atëherë pjesa e mbetur konsiderohet lëndë e huaj. Për më tepër, çfarëdo lloj materiali bimor palcor që ka diametër më të madh se 2 mm në çdo pikë të tij konsiderohet lëndë e huaj pavarësisht nga gjatësia e tij.

Borzilok i ëmbël: - në çdo material palcor bimor ka diametër më të madh se 1 mm në çdo pikë të trupit të tij ku ka bashkime, gjethet e bashkëlidhura hiqen dhe nëse gjatësia është përsëri më e madhe se 12.5 mm pjesa e mbetur konsiderohet lëndë e huaj. Për më tepër, nëse materiali bimor palcor ka dimaetër mbi 2 mm në çdo pikë të tij, ky material automatikisht konsiderohet material i huaj panvarësisht nga gjatësia e tij.